



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
LEZHË

NR.20 AKTI

Dt.Regjistimi:30.01.2018

NR.VENDIMI:20

Dt.Vendimi:02.02.2018

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë e përbërë prej:

GJYQTARE: ELSA ULLIRI

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Marie Pashuku**, sot me datë **02.02.2018**, me kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, përfaqësuar nga prokurori **Bardhok Lleshi**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, çështjen penale Nr.20 Akti, me:

OBJEKT: I.Vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të shtetasve P S , A S dhe V S sipas kësaj kronologjie:

-Pasuria me Nr. 2/276-N190, vol. 39 faqe 226, Zona Kadastrale 8160 Tiranë, me sipërfaqe 118,10 m2, lloji i pasurisë "Njësi", ndodhur në qytetin e Tiranës, Rruga "Bajram Curri", në pronësi të V S

-Pasuria me Nr. 5/52+1, Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 260,4 m2, lloji i pasurisë "Njësi" (H A), kati 10-të, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia "Fran Ivanaj", Rruga e Plazhit, Kompleksi "Adriatik", në pronësi të R S blerë tek shoqëria "E -A " sh.p.k, me Kontratë Noteriale Nr. 1137 Rep./814 Kol. datë 24.03.2017, përpiluar para Noterit V M

-Pasuria me Nr. 5/52+1-45, Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 73,85 m2, lloji i pasurisë "Apartament", kati 4 banim, Ap. Nr. 44, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia "Fran Ivanaj", Rruga e Plazhit, Kompleksi "Adriatik", në pronësi të E S dhe A S , blerë me Kontratë Noteriale Nr. 5186 Rep./3312 Kol. datë 24.03.2017, përpiluar para Noterit V M

-Pasuria me Nr. 5/52+1-45, Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 71,24 m², lloji i pasurisë “Apartament”, kati 4 banim, Ap. Nr. 45, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia “Fran Ivanaj”, Rruga e Plazhit, Kompleksi “Adriatik”, në pronësi të A S blerë nga tek shoqëria “E A ” sh.p.k, me Kontratë Noteriale Nr. 4982 Rep./3315 Kol. datë 24.03.2017, përpiluar para Noterit V M

-Pasuria me Nr. 5/70-N1, Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 128 m², lloji i pasurisë “Njësi”, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia “Fran Ivanaj”, Rruga e Plazhit, Kompleksi “Adriatik”, në pronësi të P S , blerë tek shoqëria “E ” sh.p.k, me Kontratë Noteriale Nr. 3139 Rep./2215 Kol. datë 27.07.2016, përpiluar para Noterit V M

-Pasuria me Nr. 5/70-N3, Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 128 m², lloji i pasurisë “Njësi”, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia “Fran Ivanaj”, Rruga e Plazhit, Kompleksi “Adriatik”, në pronësi të P S , blerë tek shoqëria “I ” sh.p.k, me Kontratë Noteriale Nr. 4096 Rep./2631 Kol. datë 24.08.2016, përpiluar para Noterit V M

-Pasuria me Nr. 5/70+B96, Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 13,25 m², lloji i pasurisë “Bodrum Parkimi”, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia “Fran Ivanaj”, Rruga e Plazhit, Kompleksi “Adriatik”, në pronësi të P S blerë tek shoqëria “E ” sh.p.k, me Kontratë Noteriale Nr. 3739 Rep./2964 Kol. datë 08.09.2016, përpiluar para Noterit V M

-Pasuria me Nr. 5/70-N6 Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 275,3 m², lloji i pasurisë “Njësi”, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia “Fran Ivanaj”, Rruga e Plazhit, Kompleksi “Adriatik”, në pronësi të A S blerë tek shoqëria “E ” sh.p.k, me Kontratë Noteriale Nr. 1262 Rep./914 Kol. datë 04.04.2017, përpiluar para Noterit V M

-Pasuria me Nr. 5/70-Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 21,3 m², lloji i pasurisë “Njësi”, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia “Fran Ivanaj”, Rruga e Plazhit, Kompleksi “Adriatik”, në pronësi të A S , blerë tek shoqëria “E ” sh.p.k, me Kontratë Noteriale Nr. 1261 Rep./913 Kol. datë 04.04.2017, përpiluar para Noterit V M

-Pasuria me Nr. 4/14 - N4, vol. 14 faqe 132, ndodhur në Zonën Kadastrale 8632, me sipërfaqe totale 53,125 m² plus 17,4 m² truall, loji i pasurisë “Njësi”, në pronësi të V S , e cila shërben si ambient biznesi “Farmaci” (“FARMACI ”, ndodhur në qytetin Lezhë, Lagjia “Besëlidhja”, Rruga “Kosova”, përbri Qendrës Shëndetësore të qytetit të Lezhës.

-Pasuria me Nr. 21/148, vol. 6 faqe 130, ndodhur në Zonën Kadastrale 3181, me sipërfaqe totale të parcelës ndërtimore 500 m², me sipërfaqe ndërtimi 357,4 m², lloji i pasurisë godinë banimi 2 kate + Truall, ndodhur në fshatin Rrilë, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë. Ky objekt është deklaruar per legalizim nga P S por me Deklaratën Noteriale Nr. 2228

Rep./1722 Kol. të datës 23.06.2015, P S ka hequr dorë nga pronësia duke ia kaluar të drejtat babait të tij, V S

-Pasuria me Nr. 21/58, vol. 6 faqe 128, ndodhur në Zonën Kadastrale 3181, me sipërfaqe totale 3633 m2, lloji i pasurisë "Arë", ndodhur në fshatin Rrilë, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë, në pronësi të V S

-Pasuria me Nr. 7/780, vol. 31 faqe 81, ndodhur në Zonën Kadastrale 8632, me sipërfaqe totale ndërtimi 39,61 m2 (shtesa me legalizim), me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 113 m2, e cila shërben si ambient biznesi, ndodhur në qytetin e Lezhës, Lagjia "Besëlidhja", përballë Konviktit të Shkollës Ekonomike, në pronësi të P S

-Pasuria me Nr. 7/78+1-2, vol. 2 faqe 125, ndodhur në Zonën Kadastrale 8632, me sipërfaqe totale ndërtimi 69,18 m2, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 113 m2, e cila shërben si ambient biznesi (Bar-Kafe " "), ndodhur në qytetin e Lezhës, Lagjia "Besëlidhja", përballë Konviktit të Shkollës Ekonomike, në pronësi të P S

-Pasuria me Nr. 49/44, vol. 5 faqe 154, ndodhur në Zonën Kadastrale 1099, lloji i pasurisë "Kullotë", me sipërfaqe totale 2734 m2, në pronësi të P S ndodhur në fshatin Barbullojë, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë.

-Pasuria me Nr. 22/5, vol. 1 faqe 123, ndodhur në Zonën Kadastrale 3181, lloji i pasurisë "Arë", me sipërfaqe totale 15 500 m2, në pronësi të V S , ndodhur në fshatin Rrilë, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë.

-Pasuria me Nr. 21/58, vol. 6 faqe 128, ndodhur në Zonën Kadastrale 3181, me sipërfaqe totale 3633 m2, lloji i pasurisë "Arë", në pronësi të V S , ndodhur në fshatin Rrilë, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë.

-Pasuria me Nr. 21/6, vol. 1 faqe 222, ndodhur në Zonën Kadastrale 3181, me sipërfaqe totale 1032 m2, lloji i pasurisë "Arë + truall", në pronësi të V S , V S , L S , ndodhur në fshatin Rrilë, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë.

-Një autoveturë me targë A U i markës Mercedes Benz, model E270 CDI, ngjyre e zeze, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit P S

-Një autoveturë me targë A F, e markës "DAYMLER CHRYSLER", model A CDI ngjyre e zeze; e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit P S

-Një autoveturë me targë AA G i markës Audi, model A4 ngjyre blu e erret; e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit P S

-Një autoveturë me targë AA I i markës Peugeot, model 308, ngjyre gri; e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit P S

-Një autoveturë me targë A [blank] f, i markës Ëolksvagen, model Tiguan, ngjyre gri, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit P [blank] S

-Një autoveturë me targë A [blank] C, e markës Ëolksvagen, model TOUAREG, ngjyre blu, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit L [blank] K [blank] I

-Një autoveturë me targë A [blank] X, e markës FIAT, model ULISSE, ngjyre gri, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit I [blank] K [blank] I .

-Një autoveturë me targë A [blank] M, e markës PORSCHE, model PANAMERA 4S, ngjyre kafe, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit L [blank] K [blank] L

-Një autoveturë me targë A [blank] T, e markës LAND ROVER, model RANGE ROVER VOGUE, ngjyre e bardhë, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit L [blank] K [blank] L

2. Me ekzekutimin e vendimit mbi sekuestron preventive të sipërpërmendur të ngarkohet oficeri i policisë gjyqësore Thoma Zisi.

BAZA LIGJORE: Neni 274 të K.Pr.Penale

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata, pasi administroi provat e paraqitura nga ana e prokurorisë dhe pasi dëgjoi konkluzionet përfundimtare të palëve, të cilët kërkuan:

Prokurori Bardhok Lleshi kërkoi:

"Pranimin e kërkesës."

Si dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN SE:

I. Procedura:

1. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka sjellë për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë kërkesën penale me objekt caktimin e masës së sigurimit sekuestro preventive mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të cituara në hyrje të këtij vendimi, që janë në pronësi të shtetasve P [blank] A dhe V [blank] S të cilët dyshohen për kryerjen e veprës penale "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*" të parashikuar nga neni 287 të K.Penal.

2. Përpara shqyrtimit të kërkesës, Gjykata mori në shqyrtimin juridiksionin dhe kompetencën për gjykimin e kësaj çështje penale. Juridiksioni gjyqësor penal përcaktohet nga neni 69 i K.Pr.Penale, ku shprehimisht parashikohet se: "*Juridiksioni penal ushtrohet nga*

gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në këtë kod." Duke qenë kështu, Gjykata konstaton se ka juridiksion për shqyrtimin e kësaj kërkesë penale.

3. Përsa i përket kompetencës lëndore, mbajmë në vëmendje nenin 74 të K.Pr.Penale, ku parashikohet se: *"Gjykata e rrethit gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së gjykatës për krime të rënda, gjykatës ushtarake dhe Gjykatës së Lartë."* Vepra penale për të cilën dyshohet personin nën hetim nuk bën pjesë në veprat penale që janë në kompetencë të gjykatës për krime të rënda apo Gjykatës së Lartë.

4. Ndërsa, kompetenca tokësore rregullohet nga neni 76 i K.Pr.Penale, ku parashikohet se: *"Kompetenca tokësore përcaktohet, me radhë, nga vendi ku është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja."* Gjithashtu, për masat e sigurimit i referohemi edhe nenit 244 të K.Pr.Penale që përcakton se: *"Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa."*

5. Kjo çështje do të shqyrtohet nga një gjyqtar i vetëm, bazuar në nenin 13/2/a të K.Pr.Penale që parashikon: *"Në gjykatat e shkallës së parë gjykohen nga një gjyqtar: a) kërkesat e palëve gjatë hetimit paraprak."* Si kërkesë e tillë vlerësohet edhe kërkesa e paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë në rastin konkret. Përfundimisht, Gjykata çmon se shqyrtimi i kësaj çështje hyn në juridiksionin gjyqësor dhe kompetente për shqyrtimin e saj është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

6. Gjykimi i kërkesës me objekt vendosje e sekuestros preventive u zhvillua në bazë aktesh, pa u dëgjuar pala tjetër, duke i lënë vend kontradiktoritetit të palëve për t'u zhvilluar, në rast ushtrimi të ankimit, në shkallë të dytë, bazuar në qëllimin e parashikimit në nenin 274/1 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me rrezikun e vonësës (si element i sekuestros preventive) dhe në përputhje me nenin 276/2 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon paraqitjen e ankimit nga personi i interesuar pas marrjes dijeni për sekuestron e vënë.

II. Faktet:

7. Rezulton se nga ana e drejtorisë për hetimin e krimit ekonomik e financiar pranë Drejtorisë së Policisë së Shtetit, me anë të shkresave me Nr.Prot.551/2, datë 27.01.2017 dhe Nr.Prot.551/4, datë 10.03.2017 është dërguar informacion për dyshimet që ekzistojnë për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287 të K.Penal nga ana e shtetasve P (A) dhe V S. Kështu, sipas informacionit që disponon Drejtoria për hetimin e krimit ekonomik e financiar në Drejtorinë e Përgjithshme për hetimin e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, shtetasit P e A S kanë disa të dhëna për aktivitet kriminal. Konkretisht, rezulton se shtetasi P S prej datës 18.07.1998-06.05.2016 është raportuar, arrestuar, fotodaktiloskopuar dhe i është refuzuar hyrja në aeroportin Malpensa për veprat penale të vjedhjes në rrethana rënduese, ushtrim dhune dhe rezistencë, falsifikim e deklaram të rremë të identitetit. Shtetasi A (A) S prej datës 13.03.2002-27.11.2012 është raportuar,

arrestuar dhe fotodaktiloskopuar për vepra penale në fushën e drogës, duke u dënuar edhe nga Gjykata në Trento-Itali me 4 vjet e 6 muaj burgim për falsifikim. Nga hetimet e kryera ka rezultuar se shtetasit P. A dhe V S janë vëllezër dhe kanë të regjistruar në emër të tyre një sërë pasurish të paluajshme dhe të luajshme (kryesisht automjete). Konkretisht, sipas organit të akuzës, vëllezërit P e A S kanë investuar shuma të mëdha në pasuri të paluajshme dhe biznese, të cilat nuk mund të justifikohen nga pikëpamja ekonomike dhe dyshohet se lidhen dhe rrjedhin nga veprimtaria kriminale e këtyre shtetasve, pasuri të tilla si automjete, biznese, depozita bankare, kanë lidhur kontrata të shumta shitblerje etj. Në lidhje me dyshimet për përfshirje të vëllezërve S në veprimtari kriminale nga shkresa me Nr.Prot.14970/9, datë 13.11.2017 dhe Nr.Prot.14970/11, datë 12.12.2017 të Drejtorisë së Përgjithshme për Hetimin e Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit konstatohet se nga njësia kombëtare Europol-Itali rezulton se shtetasit P. , V: dhe A S janë implikuar në veprimtari kriminale në Itali, përgjithësisht në fushën e trafikut të lëndëve narkotike. Në kuadër të operacionit “Apuleio” realizuar në vitin 2008 nga Guardia di Finanza e Trentos ndaj një grupi shqipfolës të përfshirë në trafik narkotikësh është arrestuar shtetasi A S. Në vitin 2011 nga policia e Vareses është hetuar lidhur me një grup të organizuar i përfshirë në trafik narkotikësh nga Holanda drejt Italisë, ku në kuadër të këtij hetimi janë hetuar edhe shtetasit P :V S Gjithashtu, nga informacioni i marrë në rrugë policore rezulton se është arrestuar në nëntor të vitit 2017 shtetasi V. S nga policia e Firences Itali si drejtues i një grupi kriminal që merrej me shfrytëzimin për prostitucion dhe trafikimin e lëndëve narkotike nga Amerika në Itali, duke u futur në Itali nëpërmjet Hollandës. Dyshohet se ky grup kriminal trafikonte rreth 20 kg kokainë në javë. Shkatërrimi i këtij grupi kriminal u finalizua si rrjedhojë e një hetimi të përbashkët të policisë Italiane dhe hollandeze, ku në përfundim të operacionit janë arrestuar rreth 30 persona në Itali e Hollandë, janë sekuestruar 140 kg kokainë, 70 kg marijuanë, 4.000.000 Euro dhe 8 armë. Përsa i përket të ardhurave nga punësimi, pensionet për shtetasin V S dhe familjarët e tij ka rezultuar se shtetasi V S ka të ardhura nga pensioni në total 697,577 lekë për periudhën 29.05.2015-31.12.2017. Ndërsa, sipas shkresës me Nr.Prot.4973/1, datë 18.10.2017 të DRT Lezhë, të ardhurat nga bizneset janë në total 3.433.889 lekë. Duke qenë se organi i akuzës në bazë të provave të administruara dyshon se shumata e mëdha të investuara në blerjen e pasurive të paluajshme nga ana e vëllezërve S janë produkt i veprës penale “Trafikimit të lëndëve narkotike” dhe “Shfrytëzimit për prostitucion” të kryera në Itali, Hollandë, Franë e shtete të tjera të Europës, duke qenë se nuk justifikohen me të ardhurat nga burimet e ligjshme që këta shtetas mund të sigurojnë nga bizneset e ligjshme, atëherë me qëllim mostjetërsimin e pasurive të dyshuara si produkt i veprës penale, prokuroria i është drejtuar gjykatës me anë të kësaj kërkesë.

8. Me datë 29.05.2017 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë me anë të Urdhërit “Për regjistrimin e procedimit penal”, ka vendosur regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e

veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga neni 287 të K.Penal.

9.Faktet e cituara më lart provohen nga këto prova:

9.1 Faktet e parashtruara më lart u provuan nga administrimi gjyqësor me cilësinë e provës të:

- Procesverbale “Për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale”;
- Procesverbale “Për këqyrjen e regjistrave të ZVRPP Lezhë”;
- Certifikata për vërtetimin e pronësisë;
- Të gjitha aktet e tjera të paraqitura nga ana e prokurorisë dhe të administruara në gjykim.

III. Ligji i zbatueshëm

10. Neni 274 i K.Pr.Penale i cili parashikon se: “1.Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. 3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.”

11. Neni 287 të K.Penal i cili parashikon se: “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet: a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave; d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale; dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; - dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim . Dispozitat e këtij neni

zbatohen edhe kur: a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet; b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar; c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet; ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë; d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë. Dijenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.”

III. Vlerësimi i gjykatës:

12. Gjykata vlerëson se faza e procedimit penal lidhur me caktimin masave të sigurimit, konsiderohet si “proces në procesin penal”, dhe ka funksion aksesor e incidental, në raport me procedimin kryesor mbi hetimin, e më pas ushtrimin e ndjekjes penale dhe vërtetimin e themelit të akuzës së paraqitur për gjykim. Nevojat e procedimit penal, përveç atyre lidhur me lirinë personale, domethënë lirinë fizike të personit të interesuar, mund të kenë të bëjnë edhe me sendet, në masën që ato mund të prekin apo cenojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e procedimit penal; pra, kur prania e tyre mund të rëndojë, apo të zgjasë pasojat e saj, ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, apo kur bëhet fjalë për sende të rrezikshme e të ndaluara me ligj. Në këtë rast flitet për sekuestrimin si një instrument për realizimin e shtrëngimit pasuror, krahas atij personal që ka qëllime të ndryshme. Procedura, modalitetet, si dhe kufizimet që parashikohen në procedimin mbi caktimin e masave të sigurimit pasuror nga ligji procedural penal, kanë të bëjnë me garantimin e lirive kushtetuese lidhur me pasurisë, siç janë e drejta e pronës, parashikuar nga neni 41/1 i Kushtetutës, si dhe liria e veprimtarisë ekonomike, parashikuar nga neni 11 i Kushtetutës, duke vënë në baraspeshim në vijë të drejtë interesin publik dhe mbrojtjen e shoqërisë nga veprimet kriminale, me të drejtat themelore kushtetuese të individit në raport me ndërhyrjet e shpërpjesëtuara dhe të papërligjura. Nëpërmjet vendimit mbi sekuestrimin e sendeve, autoriteti gjyqësor synon heqjen/bllokimin e një sendi/apo pasurie të përcaktuar, nga disponimi i lirë i një subjekti që e zotëron atë, duke i vendosur sendit një detyrim të caktuar, i cili mund të jetë me karakter të përkohshëm apo përfundimtar në rastin e veprimtarive të ndaluara me ligj. Sa i përket qëllimeve të caktuara që kërkohen të ndiqen me anë të vendimit për sekuestrimin e sendit, në bazë të nevojave procedurale, ligji procedural penal parashikon tre kategori sekuestrimesh. E para ka të bëjë me qëllimin e vërtetimit të fakteve të procedimit dhe përbën një mjet për kërkimin e provës, sipas nenit 208 të KPP; pra sekuestrimi për qëllim mbledhjen e provave materiale, nuk përbën një masë sigurimi pasuror, madje është pikërisht qëllimi për sekuestrimin e provave elementi që dallon këtë institut, nga sekuestroja preventive dhe ajo konservative, të parashikuar nga ligji procedural si masa sigurimi pasuror. Sekuestroja konservative ka të bëjë me vendosjen e një detyrimi në sendet e luajtshme ose të paluajtshme të të pandehurit ose të shumave a sendeve që të tjerët i detyrohen atij, në caqet që ligji lejon

sekuestrimin e tyre, të pandehurit apo të paditurit civil me qëllim pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit, sipas neneve 270-273 të Kodit të Procedurës Penale. **Sekuestroja preventive**, në bazë të neneve 274-276 të Kodit të Procedurës Penale, urdhërohet në rastin kur ekziston rreziku që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, apo edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. Bazuar në analizën sistematike të dispozitës ligjore, vëren se sekuestroja preventive mund të urdhërohet për "qëllime të parandalimit" të pasojave apo veprimeve të paligjshme kriminale, në rastet e parashikuara prej pikës "1" të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa në rastet e parashikuara prej pikës "2", të po këtij neni, sekuestroja preventive mund të urdhërohet për "qëllime të sekuestrimit", sipas përcaktimeve të parashikuara nga neni 36 i Kodit Penal. Në rastin e dytë, kemi të bëjmë me një "goditje" më efektive të avantazheve ekonomike që vijnë si rezultat i veprimtarive kriminale, dhe masa në fakt merr trajtën e një sanksioni penal. Kushtet e nevojshme ligjore për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive njëkohësisht janë: prania e indicjeve, d.m.th prania e elementit të ashtuquajtur *fumus boni iuris*, si dhe prania e elementit të ashtuquajtur *periculum in mora* [rreziku i vonësës] deri në kalimin e vendimit në gjë të gjykuar. Sa i takon elementit të *fumus boni iuris*, në bazë të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, rezulton se për zbatimin e sekuestros preventive, është e nevojshme hetimi dhe marrja e të dhënave dëshmuuese rreth kryerjes (së mundshme në të ardhmen e afërt) së një fakti që përbën vepër penale të parashikuar dhe të cilësuar në bazë të një dispozite të Kodit Penal, si dhe verifikimi i faktit të një rëndimi, apo zgjatjeje të pasojës së veprës penale, apo të një lehtësimi të kryerjes së veprave të tjera penale, në raport me rrethanat dhe veçoritë e faktit konkret të supozuar se është kryer apo do të kryhet. Objekti i sekuestros preventive përcaktohet shprehimisht në sendet që lidhen me veprën penale të supozuar se është kryer, prandaj nuk duhet lejuar caktimi i masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive përpara se të jetë kryer vepra penale, apo thjesht një shpjegim i normës penale abstrakte. Për këtë arsye, është e nevojshme prania e një sërë indicjeve që lidhin sendin apo pasurinë me natyrën dhe llojin e veprës penale të supozuar nga ana e organit të akuzës në raport edhe me faktet e parashtruara apo të grumbulluara mbi çështjen konkrete. Këto indicje nuk duhet të vlerësohen në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme, por mbi baza aktuale dhe konkrete, mbështetur në të dhëna objektive që hedhin dritë mbi rëndimin, zgjatjen, apo kryerjen e të tjerave veprime kriminale, në raport me cenimin që i bëhet marrëdhënies juridike të mbrojtur nga norma penale. Gjithashtu, gjykata e themelit duhet të verifikojë dhe të argumentojë edhe mbi praninë e një sërë indicjeve që krijojnë dyshimin e arsyeshëm se do të arrihet një vendim dënimi. Sa i takon pranisë së elementit të *periculum in mora*, Kolegji verën se ky element përbën vetë qëllimin e nevojshëm për caktimin e kësaj mase mbi pasurinë, pra në shmangien e ardhjes ose zgjatjes së pasojave nga vepra penale apo të lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale. Në këtë mënyrë, elementi i *periculum in mora*, nuk duhet të konsiderohet si një eventualitet i përgjithshëm e abstrakt, por si një probabilitet realist, që sendi objekt i mundshëm sekuestrimi preventiv, të bëhet shkak rëndues, zgjatës, për veprën penale të supozuar,

apo shkak lehtësues për vepra të tjera të supozuara se mund të ndodhin efektivisht. Kjo mbështetur në llojin dhe natyrën e sendit dhe tërësinë e rrethanave konkrete, dhe duke u bazuar në nevoja reale dhe jo gjasa thjesht teorike. Objekti i sekuestros preventive, sipas pikës "1" të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, përbëhet nga "sendet që lidhen me veprën penale", domethënë nga marrëdhënia e krijuar midis sendit dhe veprës penale të kryer, apo me të ardhurat që vijnë si rezultat i kryerjes së veprës penale, po të vazhdojë mbajtja e mëtejshme e sendit. Kolegji çmon se është e kuptueshme që kemi të bëjmë me një raport midis sendit dhe veprës penale, i cili nuk është i rastësishëm, por i konceptuar dhe vënë në funksion të natyrës së veprës penale. Në rastin e pikës "2" të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, objekti i sekuestros përbëhet nga sendet e sekuestrueshme, në kuptim të nenit 36 të Kodit Penal, por të qenit i sekuestrueshëm i sendit, nuk është kusht i vetëm për përligjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, pasi edhe në këtë rast, janë të nevojshme prania e dy këtyre elementëve. Së pari: prania e elementit të *fumus commissis delicti*, domethënë që sendi duhet të ketë qenë ai që ka shërbyer apo ai i destinuar për kryerjen e veprës penale, apo se është pikërisht ai që përbën produktin e veprës penale, shpërblimeve, të dhëna, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i së cilit, përbën veprën penale. Së dyti, është e nevojshme vërtetimi i një lidhjeje të posaçme, funksionale dhe jo të rastësishme (domethënë të qëndrueshme) midis sendit dhe veprimit penal të kundërligjshëm. Gjykata verën se, megjithëse kemi të bëjmë me një marrëdhënie midis sendit dhe veprës penale të kryer, jurisprudenca e GjEDNj-së, (Vendimi datë 20.01.2009, Sud Fondi s.r.l, etj. kundër Italisë; vendimi datë 30.08.2007, Sud Fondi s.r.l, etj. kundër Italisë; Vendimi datë 01.03.2007, Geerings kundër Vendeve të Ulëta), ka përcaktuar se gjithsesi nuk mund të mos mbahet në konsideratë edhe verifikimi i veprimit të një personi, si dhe duhet të përjashtuar konfiskimi ndaj subjekteve që gjenden jashtë rrethanave të kryerjes së veprës penale, për të cilët provohet prania e mirëbesimit.¹

13. Në rastin konkret, Gjykata i referohet nenit 274 të K.Pr.Penale që parashikon se: "1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. 3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron." Nga interpretimi i këtij neni rezulton se, sekuestroja preventive në bazë të neneve 274-276 të Kodit të Procedurës Penale urdhërohet në rastin kur ekziston rreziku që disponimi i lirë i një sendi, që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj, të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera (Neni 274/1 i K.Pr.Penale). Po ashtu, sekuestroja preventive lejohet edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal

¹ Vendimi Nr.201, datë 09.12.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

(Neni 274/2 i K.Pr.Penale). Sekuestroja preventive mund të urdhërohet për “qëllime të parandalimit” të pasojave apo veprimeve të paligjshme kriminale, në rastet e parashikuara prej pikës “1” të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa në rastet e parashikuara prej pikës “2”, të po këtij neni, sekuestroja preventive mund të urdhërohet për “qëllime të sekuestrimit”, sipas përcaktimeve të parashikuara nga neni 36 i Kodit Penal. Në rastin e dytë, kemi të bëjmë me një “goditje” më efikase të avantazheve ekonomike që vijnë si rezultat i veprimtarive kriminale, dhe masa në fakt merr trajtën e një sanksioni penal. Pra, referuar nenit 274 të K.Pr.Penale që të vendoset sekuestrimi i një sendi me vendim gjykate, duhet të ekzistojë një nga rastet: të ketë rrezik që disponimi i lirë i sendit që lidhet me veprën penale të mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. Ky vendim merret me kërkesën e prokurorit, drejtuar gjykatës. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet sipas nenit 36 të K.Penal.

14. Gjykata vlerëson se në bazë të analizës së mësipërme për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive duhet të plotësohet njëkohësisht dy kushte kumulative që janë:

a) *Së pari*, prania e indicjeve rreth kryerjes (së mundshme në të ardhmen e afërt) të një fakti që përbën vepër penale sipas dispozitave të Kodit Penal, si dhe verifikimi i faktit të një rëndimi, apo zgjatjeje të pasojës së veprës penale, apo të një lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale, në raport me rrethanat dhe veçoritë e faktit penal të dyshuar se është kryer apo do të kryhet. Në rastin objekt gjykimi, Gjykata çmon se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se nga personat e dyshuar është kryer vepra penale e parashikuar nga neni 287 i K.Penal. Ky dyshim provohet nga tërësia e provave të paraqitura në gjykim prej organit të akuzës, që tregojnë se shtetasit Parlind, Aleks dhe Valentin Selaj kanë të regjistruar një sërë pasurish të paluajtshme dhe të luajtshme, por që nuk justifikohen me të ardhurat nga burime të ligjshme. Ndërkohë që provohet edhe fakti se shtetasit e mësipërm janë proceduar, janë në procedim apo edhe janë dënuar për vepra të ndryshme, kryesisht për trafik të lëndëve narkotike në shtetin italian.

b) *Së dyti*, të ekzistojë rreziku që disponimi i lirë i pasurisë të zgjasë pasojat e veprës penale ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale në të ardhmen. Kështu, zbatimi i masës së sigurimit pasuror “*Sekuestro preventive*” duhet të ketë si qëllim shmangien e ardhjes, zgjatjes së pasojave nga vepra penale apo shmangien e lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale. Ky kusht nuk duhet vlerësohet në mënyrë abstrakte, por si një probabilitet realist, që sendi objekt i sekuestros preventive, të bëhet shkak rëndues, zgjatës, për veprën penale të supozuar, apo shkak lehtësues për vepra të tjera mund të kryehen në të ardhmen. Ky kusht përbën vetë qëllimin për caktimin e kësaj mase mbi pasurinë. Në çështjen objekt gjykimi, Gjykata vlerëson se caktimi i masës së sigurimit pasuror sekuestro preventive është i domosdoshëm në rastin konkret për shkak se, ekziston dyshimi se disponimi i lirë i këtyre sendeve mund të bëhet shkak për zgjatjen e pasojave të veprës penale ose për lehtësimin e kryerjes së veprave penale të tjera. Kështu,

dyshohet se pasuritë objekt gjykimi janë produkt i veprave penale për të cilat janë proceduar, janë në procedim apo janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë të dyshuarit. Disponimi i lirë i këtyre pasurive mund të zgjasë pasojat e veprës penale dhe në të njëjtën kohë mund të lehtësojë kryerjen, në të ardhmen, të veprave të tjera penale. Në lidhje me vendosjen e sekuestros edhe mbi pasuritë e luajtshme të shtetasit I L , Gjykata mban parasysht faktin se për qëllim të caktimit të masës së sigurimit pasuror sekuestro preventive nuk është kusht njohja apo dyshimi në personin që i atribuohet vepra penale dhe përkatësia e pronësisë së sendit. Mund të jetë objekt i sekuestros preventive si sendi që i përket personit që i atribuohet vepra ashtu edhe sendi që i përket një personi të tretë apo të dëmtuarit nga vepra penale. Në rastin konkret, dyshohet se pasuritë i përkasin vëllezërve Selaj, por që janë regjistruar në emër të dajës së tyre, shtetasit L L

15. Për sa më sipër, gjykata çmon se kërkesa e paraqitur nga prokurori është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të pranohet.

Përfundimisht, Gjykata

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 274 e vijues të K.Pr.Penale,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Vendosjen e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme:
 - Pasuria me Nr.2/276-N190, vol.39, faqe 226, Zona Kadastrale 8160, Tiranë, me sipërfaqe 118,10 m2, lloji i pasurisë "Njësi", ndodhur në qytetin e Tiranës, Rruga "Bajram Curri", në pronësi të V S
 - Pasuria me Nr.5/52+1, Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 260,4 m2, lloji i pasurisë "Njësi" (H A), kati 10-të, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia "Fran Ivanaj", Rruga e Plazhit, Kompleksi "Adriatik", në pronësi të R S blerë tek shoqëria "E " sh.p.k, me Kontratë Noteriale Nr. 1137 Rep./814 Kol. datë 24.03.2017, përpiluar para Noterit V M .
 - Pasuria me Nr.5/52+1-45, Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 73,85 m2, lloji i pasurisë "Apartament", kati 4 banim, Ap. Nr. 44, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia "Fran Ivanaj", Rruga e Plazhit, Kompleksi "Adriatik", në pronësi të E S dhe A S blerë me Kontratë Noteriale Nr. 5186 Rep./3312 Kol. datë 24.03.2017, përpiluar para Noterit V M


- Pasuria me Nr.5/52+1-45, Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 71,24 m2, lloji i pasurisë “Apartament”, kati 4 banim, Ap. Nr. 45, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia “Fran Ivanaj”, Rruga e Plazhit, Kompleksi “Adriatik”, në pronësi të A S , blerë nga tek shoqëria “E ” sh.p.k, me Kontratë Noteriale Nr. 4982 Rep./3315 Kol. datë 24.03.2017, përpiluar para Noterit V M .
- Pasuria me Nr.5/70-N1, Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 128 m2, lloji i pasurisë “Njësi”, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia “Fran Ivanaj”, Rruga e Plazhit, Kompleksi “Adriatik”, në pronësi të P S , blerë tek shoqëria “J ” sh.p.k, me Kontratë Noteriale Nr. 3139 Rep./2215 Kol. datë 27.07.2016, përpiluar para Noterit V M
- Pasuria me Nr.5/70-N3, Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 128 m2, lloji i pasurisë “Njësi”, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia “Fran Ivanaj”, Rruga e Plazhit, Kompleksi “Adriatik”, në pronësi të P S , blerë tek shoqëria “J ” sh.p.k, me Kontratë Noteriale Nr. 4096 Rep./2631 Kol. datë 24.08.2016, përpiluar para Noterit V M.
- Pasuria me Nr.5/70+B96, Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 13,25 m2, lloji i pasurisë “Bodrum Parkimi”, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia “Fran Ivanaj”, Rruga e Plazhit, Kompleksi “Adriatik”, në pronësi të P S , blerë tek shoqëria “J ” sh.p.k, me Kontratë Noteriale Nr. 3739 Rep./2964 Kol. datë 08.09.2016, përpiluar para Noterit V M .
- Pasuria me Nr.5/70-N6 Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 275,3 m2, lloji i pasurisë “Njësi”, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia “Fran Ivanaj”, Rruga e Plazhit, Kompleksi “Adriatik”, në pronësi të A S , blerë tek shoqëria “J ” sh.p.k, me Kontratë Noteriale Nr. 1262 Rep./914 Kol. datë 04.04.2017, përpiluar para Noterit V M.
- Pasuria me Nr. 5/70-N7, Zona Kadastrale 3126, me sipërfaqe 21,3 m2, lloji i pasurisë “Njësi”, ndodhur në qytetin e Shëngjinit, Lagjia “Fran Ivanaj”, Rruga e Plazhit, Kompleksi “Adriatik”, në pronësi të A S blerë tek shoqëria “J ” sh.p.k, me Kontratë Noteriale Nr. 1261 Rep./913 Kol. datë 04.04.2017, përpiluar para Noterit V M.
- Pasuria me Nr.4/14 - N4, vol.14, faqe 132, ndodhur në Zonën Kadastrale 8632, me sipërfaqe totale 53,125 m2 plus 17,4 m2 truall, loji i pasurisë “Njësi”, në pronësi të V S , e cila shërben si ambient biznesi “Farmaci” (“FARMACI ”), ndodhur në qytetin Lezhë, Lagjia “Besëlidhja”, Rruga “Kosova”, përbri Qendrës Shëndetësore të qytetit të Lezhës.

- Pasuria me Nr.21/148, vol.6, faqe 130, ndodhur në Zonën Kadastrale 3181, me sipërfaqe totale të parcelës ndërtimore 500 m2, me sipërfaqe ndërtimi 357,4 m2, lloji i pasurisë godinë banimi 2 kate + Truall, ndodhur në fshatin Rrilë, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë. Ky objekt është deklaruar për legalizim nga P S , por me Deklaratën Noteriale Nr. 2228 Rep./1722 Kol. të datës 23.06.2015, P S ka hequr dorë nga pronësia duke ia kaluar të drejtat babait të tij, V S
- Pasuria me Nr.21/58, vol.6, faqe 128, ndodhur në Zonën Kadastrale 3181, me sipërfaqe totale 3633 m2, lloji i pasurisë “Arë”, ndodhur në fshatin Rrilë, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë, në pronësi të V S
- Pasuria me Nr. 7/780, vol.31, faqe 81, ndodhur në Zonën Kadastrale 8632, me sipërfaqe totale ndërtimi 39,61 m2 (shtesa me legalizim), me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 113 m2, e cila shërben si ambjent biznesi, ndodhur në qytetin e Lezhës, Lagjia “Besëlidhja”, përballë Konviktit të Shkollës Ekonomike, në pronësi të P S
- Pasuria me Nr.7/78+1-2, vol.2, faqe 125, ndodhur në Zonën Kadastrale 8632, me sipërfaqe totale ndërtimi 69,18 m2, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 113 m2, e cila shërben si ambjent biznesi (Bar-Kafe “j ”), ndodhur në qytetin e Lezhës, Lagjia “Besëlidhja”, përballë Konviktit të Shkollës Ekonomike, në pronësi të P S
- Pasuria me Nr.49/44, vol.5, faqe 154, ndodhur në Zonën Kadastrale 1099, lloji i pasurisë “Kullotë”, me sipërfaqe totale 2734 m2, në pronësi të P S ndodhur në fshatin Barbullojë, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë.
- Pasuria me Nr.22/5, vol.1, faqe 123, ndodhur në Zonën Kadastrale 3181, lloji i pasurisë “Arë”, me sipërfaqe totale 15 500 m2, në pronësi të V S , ndodhur në fshatin Rrilë, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë.
- Pasuria me Nr.21/6, vol.1, faqe 222, ndodhur në Zonën Kadastrale 3181, me sipërfaqe totale 1032 m2, lloji i pasurisë “Arë + truall”, në pronësi të V S V S L S , ndodhur në fshatin Rrilë, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë.
- Një autoveturë me targë A U i markës Mercedes Benz, model E270 CDI, ngjyre e zeze, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit P S
- Një autoveturë me targë A F, e markës “DAYMLER CHRYSLER”, model A180 CDI ngjyre e zeze; e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit P S
- Një autoveturë me targë A 3 i markës Audi, model A4 ngjyre blu e erret; e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit P S

- Një autoveturë me targë A. H i markës Peugeot, model 308, ngjyre gri; e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit P S.
 - Një autoveturë me targë A. PJ, i markës Ëolkswagen, model Tiguan, ngjyre gri, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit P S.
 - Një autoveturë me targë A. C, e markës Ëolkswagen, model TOUAREG, ngjyre blu, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit L K L.
 - Një autoveturë me targë A. X, e markës FIAT, model ULISSE, ngjyre gri, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit L K L.
 - Një autoveturë me targë A. M, e markës PORSCHE, model PANAMERA 4S, ngjyre kafe, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit L K L.
 - Një autoveturë me targë A. T, e markës LAND ROVER, model RANGE ROVER VOGUE, ngjyre e bardhë, e regjistruar në DRSHTRR Laç, në emër të shtetasit Luigj K L.
3. Për ekzekutimin e sekuestros ngarkohet oficeri i policisë gjyqësore, Thoma Zisi.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga cilido që ka interes, në Gjykatën e Apelit Shkodër, brenda 10 ditëve nga dhënia e vendimit ose nga dita që i interesuari ka marrë dijeni për sekuestron e vënë.

U shpall sot në Lezhë, me datë 02.02.2018.

SEKRETARE
MARIE Pashuku



GJYOTARE
ELSA ULLIRI

